



REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËS DHE
POLITIKËS SOCIALE

DORACAK PËR BUXHETIM PËRGGJEGJË GJINOR PËR ADMINISTRATËN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË





QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE
DORACAK PËR BUXHETIM PËRGJEGJËS GJINOR PËR ADMINISTRATËN
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Qershor, 2013



Austrian

Development Cooperation

Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit rajonal "Promovimi i Politikave të Përgjegjshme Gjinore në Evropën Juglindore" (2011-2013), të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women). Projekti është mbështetur financiarisht nga UN Women dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADC).

Këndvështrimet dhe opinionet e shprehura në këtë publikim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Agjencisë Austriake për Zhvillim, UN Women, Kombeve të Bashkuara ose të organizatave të bashkangjitura me të.

PERMBAJTJA

I. HYRJE	3
II. IDEJA PËR BUXHETIM GJINOR	5
Përse buxheti gjinor	7
Çka është buxheti përgjegjës gjinor	7
Çka nuk është buxhetim përgjegjës gjinor	8
Kujdes i kujt është buxheti gjinor	10
Kush është i përfshirë në procesin e buxhetimit përgjegjës gjinor	12
Faktorët që ndikojnë në kualitetin e buxhetimit gjinor	14
III. BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE PLANET STRATEGJIKE	15
Buxheti i RM-së	15
Procesi i miratimit të buxhetit	18
Korrelacionet e planeve strategjike dhe buxheti	19
IV. PIKAT HYRËSE PËR FILLIM TË PROCESIT TË BUXHETIMIT PËRGJEGJËS GJINOR	20
Programet, prioritetet dhe qëllimet strategjike qeveritare	21
Planet strategjike, Propozim-plani i programeve për zhvillim dhe qarkullim buxhetor	23
V. METODAT DHE MJETET PËR BUXHETIM PËRGJEGJËS GJINOR	27
<i>Mjetet për analizë buxhetore gjinore</i>	28
1. Vlerësimi senzitiv gjinor i politikave	28
2. Vlerësimi i ndarë gjinor i shfrytëzuesve	30
3. Analiza e ndarë gjinore e shpenzimeve publike	31
4. Analiza e ndarë gjinore e të hyrave publike	33

5. Analiza e ndarë gjinore e buxhetit nga aspekti i shfrytëzimit të kohës	35
6. Formulimi i politikës ekonomike afatmesme senzitive-gjinore	37

Si të arrihen politikat, strategjitë dhe buxhetet përgjegjëse gjinore – qasja në pesë hapa 40

1. Analiza e gjendjeve lidhur me femrat dhe meshkujt në sektorin në fjalë	41
2. Analiza e politikës, programit dhe ndikimi i saj në çështjet gjinore	43
3. Analiza e alokacioneve buxhetore	43
4. Ndjekja e shpenzimit dhe sigurimi i shërbimeve	43
5. Analiza e rezultateve	45

ANEKSET

Aneksi 1 Qarkullimi buxhetor, formulari A1 dhe A2	46
Aneksi 2 Baza ligjore për buxhetim përgjegjës gjinor	49
Aneksi 3 Lista e nocioneve	52

BIBLIOGRAFIA 57

DORACAK PËR BUXHETIM PËRGJEGJËS GJINOR PËR ADMINISTRATËN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

HYRJE

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale i vazhdon angazhimet e veta për përparim të përhershëm të politikave të barazisë gjinore. Miratimi i Strategjisë për Futjen e Buxhetimit Përgjegjës Gjinor në Republikën e Maqedonisë 2012-2017; Analiza Buxhetore-Gjinore e Politikave Aktive të Punësimit dhe Mbrojtjes Sociale dhe ky doracak para jush, janë vetëm një pjesë e iniciativave të Qeverisë të orientuara në përmirësimin e politikave për përparim të barazisë gjinore.

Të vetëdijshëm se përfshirja e perspektivës gjinore në buxhetin nacional është proces, zbatimi i të cilit kërkon kohë, vlera për sugjerimin e tij është me rëndësi vetvetiu për shumë arsye: t'i nxis të gjithë aktorët relevantë kur mendojnë për buxhetet dhe politikat ekonomike që vendimet e tyre t'i themelojnë në analiza që i njohin disparitetet sociale dhe ekonomike që ekzistojnë në shoqëri; ta njohin ndikimin e ndryshëm të politikave të meshkujve dhe femrave dhe të grupeve të ndryshme sociale në shoqëri; të nxisim përgjegjësi më të madhe për të gjithë që marrin pjesë në procesin e krijimit dhe implementimit të politikave dhe të hapim për tejkalimin e tyre në interes të jetës më të mirë dhe më kualitative për të gjithë qytetarët.

Pikërisht nga këto shkaqe, futja e konceptit gjinor, në këtë doracak është dhënë në dritën e procesit të planifikimit strategjik dhe pasqyrimin të prioriteteve në buxhet si një rën ndër mënyrat kryesore për përfshirjen e perspektivave gjinore në krijimin dhe implementimin e politikave publike të përcjella me mjetet buxhetore.

Doracaku dedikohet për nëpunësit shtetërorë dhe në përgjithësi për administratën, i cili e ka njërin ndër rolet kryesore në ndërmarrjen e hapave të mëtutjeshme për zbatim të parimeve të barazisë gjinore në implementimin e programeve dhe politikave të Qeverisë.

Shpresojmë se këto pika kryesore, të prezantuara nëpër një varg hapash dhe metodash e mjetesh analitike më shpesh të shfrytëzuara, do t'u shërbejnë të punësuarve në administratë që në aspekt gjinor t'i sensibilizojnë planet dhe buxhetet e tyre. Kjo do të rezultonte me rindarjen e resurseve, aty ku është e domosdoshme, me qëllim të promovohet barazia gjinore dhe të rritet efikasiteti i politikave qeveritare.

Njëherit e shfrytëzojmë këtë mundësi t'i falënderohemi UN Women – Trupit të Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Forcim të Femrave i cili dha mbështetje të plotë dhe jovetjake në realizimin e të gjitha këtyre aktiviteteve.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
Spektori për Mundësi të Barabarta

IDEJA PËR BUXHETIM GJINOR

Përse buxhetimi përgjegjës gjinor?

Supozimi se buxhetet nacionale janë neutral në aspekt gjinor dhe në esencën e procesit të buxhetimit nuk ka pabarazi, dhe se fitimet për meshkujt dhe femrat janë të barabarta, janë një nga shkaqet përse teoricienët dhe praktikuesit e iniciojnë idenë për buxhetim gjinor. Pra, parashikimi i këtyre politikave dhe buxheteve ekonomike, nuk i merr parasysh rolet e ndryshme të meshkujve dhe femrave në shoqëri, mundësitë dhe nevojat e tyre dhe nuk njeh se politikat e shndërruara në nocione monetare mund t'i nxisin dhe t'i thellojnë pabarazitë ekzistuese.

Qëllimet e futjes së perspektivës gjinore në buxhete është të sigurojë se buxhetet dhe politikat ekonomike themelohen në analiza që i njohin pabarazitë sociale dhe ekonomike dhe punojnë në tejkalimin e tyre në interes të bashkësisë.

Pikërisht për këtë edhe ideja për konceptin gjinor qëndron edhe në teorinë për rritjen ekonomike, zhvillimin e shteteve bashkëkohore, si dhe në indekset për kualitetin e jetës, të cilat janë gjithnjë e më tepër indikatorë për potencialin e një shteti të ballafaqohet me sfidat e kohës së re.

Vetvetiu koncepti gjinor ndihmon t'i kuptojmë nevojat, interesat dhe prioritetet e ndryshme të meshkujve dhe femrave nga grupe të moshave të ndryshme, bashkësive etnike dhe vendbanimeve, në sferën ekonomike, politike dhe sociale në shoqëri që të ndikojmë në drejtim të ndryshimit të roleve tradicionale dhe statusit të meshkujve dhe femrave.

Kështu, pabarazia, në cilindo qoftë kuptim, ka edhe ndikim të drejtpërdrejtë të pavorshëm mbi tërë zhvillimin e bashkësisë, respektivisht çmimi i pabarazisë është rritja më e vogël dhe efikasiteti më i ulët. Mospasja e mundësive apo zvogëlimi i mundësive për një grup të caktuar do të thotë se pasuria më e

çmueshme e shtetit – populli i saj – nuk shfrytëzohet plotësisht¹. Me shfrytëzimin e tërë potencialit dhe pjesëmarrjen më të madhe të popullit në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore, sigurohet dinamika, inovativiteti dhe përshtatshmëria, kurse gjatë kohës së ndryshime të përditshme, këto janë karakteristikat më të rëndësishme të shtetit bashkëkohor dhe të zhvilluar. Andaj, vendet e zhvilluara konsiderohen si vende të mundësive dhe kualitetit të lartë të jetës ku çdokush mund ta shfrytëzojë potencialin e tij dhe të kontribuojë në përparim në cilindo sferë.

Me buxhetimin gjinor, gjithashtu, sugjerohet në vlerën e punës së papaguar të femrës dhe të aktiviteteve të tyre (kujdesi për familjen, kujdesi dhe përkujdesja e anëtarëve të sëmurë dhe të pafuqishëm të familjes e a.q. ekonomia e kujdesit dhe përkujdesjes), të cilat duhet të vështrohen si faktor esencial gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave.

Çka është buxhetimi përgjegjës gjinor?

Buxhetimi gjinor është njëra ndër masat me të cilën mund të ndikohet për tejkalim të pabarazisë gjinore.

Sipas Këshillit të Evropës, buxhetimi përgjegjës gjinor është „futja e parimit të barazisë gjinore në proceset buxhetore. Kjo nënkupton vlerësim të bazuar gjinor të buxhetit, përfshirje të perspektivës gjinore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturim i të hyrave dhe shpenzimeve me qëllim të përparimit të barazisë gjinore”.²

Bëhet fjalë për proces nëpër të cilin rishqyrtohen buxhetet publike me qëllim të vlerësohet nëse dhe sa e përfshijnë dhe/apo kontribuojnë për barazinë ndërmjet meshkujve dhe femrave, dhe si do të propozohen ndryshime në drejtim të arritjes së barazisë gjinore.

¹ „The Price of Inequality” – Joseph Stiglitz, kolumnë për Project Syndicate, 5 qershor 2012, <http://www.project-syndicate.org/commentary/the-price-of-inequality>

² Gender Budgeting - Final report of the Group of specialist on gender budgeting (EG-S-GB), (Këshilli i Evropës, Strasburg 2005)

Duke e pasur parasysh faktin se çdo politikë publike duhet të pasqyrohet në mënyrë adekuate edhe në buxhet, në të vërtetë rishqyrtohet se sa politikat publike janë me përgjegjësi gjinore dhe në çfarë mase caktimet parimore për barazi gjinore janë të përcjella me alokim të mjeteve buxhetore adekuate. Në këtë mënyrë analizohen shpenzimet e ndara dhe ndikimi i tyre mbi pozitën shoqërore dhe ekonomike të femrave dhe meshkujve. Pastaj sugjerohet në vendet potenciale të cilat mund të jenë shkak për pabarazi dhe ku është e domosdoshme, bëhet rindarja e resurseve me qëllim të realizohet barazia.

Por, gjatë ndarjes së resurseve duhet të kihet kujdes në faktin se meshkujt dhe femrat kanë nevoja dhe interesa të ndryshme të cilat dalin nga rolet e ndryshme që meshkujt dhe femrat, vajzat dhe djemtë i kanë në shoqëri. Nga këto shkaqe, është e domosdoshme të njihet se arritja e barazisë më të madhe gjinore dhe përballimi me pabarazitë e përhershme, shpeshherë, do të thotë të punohet ndryshe me femrat dhe meshkujt, të njihen pengesat e ndryshme me të cilat këta ballafaqohen, por edhe të njihen nevojat, prioritetet dhe aspiratat e ndryshme.

Si rrjedhojë, buxhetimi gjinor nuk është i kufizuar vetëm në sferën e politikës sociale, por koncepti i buxhetimit gjinor është pjesë përbërëse e çdo shpenzimi buxhetor. Segment gjinor kanë projektet infrastrukurore, projektet për mbrojtjen e mjedisit jetësor, politikat për zhvillim ekonomik, arsimor, kulturor dhe sportiv, etj.

Shembull për buxhetimin përgjegjës gjinor

Caktimi i Qeverisë është të nxitet sporti tek të rinjtë për arritjen e rezultateve sportive. Si njëra ndër aktivitetet është të ndërtohen salla sportive, fusha futbollit dhe pishina.

Kjo masë është projekt infrastrukturor, njëherit lidhet edhe me zhvillimin kulturor, respektivisht zhvillimin sportiv.

Si kjo masë ka dimension gjinor?. Më rëndomë kjo mund të shihet në pyetjet vijuese:

- *Cila është përqindja e përfaqësimit të meshkujve dhe femrave në vendin ku do të ndërtohet salla, si shfrytëzues potencialë të sallës?*
- *Nëse sportet që do të prezantohen janë që vizitohen më tepër nga meshkujt apo femrat?*
- *Cilat janë efektet dhe ndikimi i këtij projekti, nëse ndërtimi i sallave sportive dhe fushave të futbollit do ta realizojë qëllimin dhe në mënyrë të barabartë do ta nxis sportin edhe tek meshkujt edhe tek femrat?*

Qëllimi përfundimtar i buxhetimit gjinor është krijimi i buxhetit në të cilin integrohet koncepti gjinor, përkatësisht grumbullimi i të hyrave dhe krijimi i planeve për shpenzim publik në të cilat reflektohet shpërndarja e barabartë e resurseve.

Çka është buxhetimi gjinor?

Gjatë zbatimit të konceptit të buxhetimit gjinor shumë lehtë mund të vihet në një rezultat përfundimtar të gabuar i cili do të ketë efekt negativ për promovimin e barazisë gjinore, si dhe për joefikasitet të politikave dhe shpenzimeve buxhetore.

Pasqyra vijuese sugjeron në disa nga aktivitetet të cilat nuk janë krejtësisht kompatible me zbatim të buxhetimit gjinor, në mënyrën në të cilën janë sqaruar në doracak.

Kështu, kjo nuk e përjeton mundësinë që këto aktivitete të ndodhin pavarësisht nga procesi i buxhetimit gjinor.

Aktiviteti	Shkaku
Formimi i fondeve paralele për femra	Stimulon ndarjen e programeve, që është shpenzim joadekuatë, sepse humbet kohezioni i politikave.
Veçimi i mjeteve të barabarta për meshkujt dhe femrat	Meshkujt dhe femrat nuk kanë nevoja të barabarta. Veçimi duhet të jetë adekuatë i nevojave prej rastit në rast, me qëllim përfundimtar, mundësitë e barabarta.
Veçimi i mjeteve me një „çelës“ të caktuar	Mjetet e veçuara nuk i pasqyrojnë drejtpërdrejtë nevojat. Rrethanat e ndryshme ndikojnë në çdo gjendje.
Favorizimi i femrave	Në kundërshtim me konceptin gjinor i cili duhet të stimulojë barazi dhe mundësi të barabarta edhe për meshkujt edhe për femrat.

Kujdes i kujt është buxhetimi gjinor

Baza juridike³ e cila e garanton barazinë gjinore vetvetiu paraqet parakusht të mjaftueshëm për buxhetimin përgjegjës gjinor dhe për përfshirjen e perspektivave gjinore në programet dhe prioritetet qeveritare. Kështu, pasi bëhet fjalë për një proces kompleks, ku kualiteti i programeve dhe iniciativave të përfshira varet nga më tepër grupe të ndryshme të cilat duhet të involvohen, në përgjithësi kujdesi për realizimin e barazisë gjinore duhet të jetë e të gjithëve që krijojnë politika, sepse të gjitha politikat ndikojnë në sferat e jetës së përditshme, sikurse te femrat, ashtu edhe te meshkujt. Në rend

³ Ligji për mundësi të barabarta të meshkujve dhe femrave, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 6/2012

të parë, këta janë nëpunësit shtetërorë dhe ministrat, e pastaj, të gjithë ata të cilët janë në njëfarë mënyre të përfshirë apo të prekur nga këto politika.

Kush është i përfshirë në procesin e buxhetimit përgjegjës gjinor

Aktorë të procesit të buxhetimit përgjegjës gjinor janë nëpunësit e njëjtë shtetërorë, ministrat, kryetarët e komunave, deputetët, këshilltarët në vetadministrimin lokal, koordinatorët për mundësi të barabarta të meshkujve dhe femrave etj., të cilët drejtpërdrejtë apo tërthorazi janë të përfshirë në procesin e miratimit të buxhetit dhe planeve strategjike. Kjo do të thotë se miratimi i buxhetit dhe buxhetimit gjinor nënkupton proces të njëjtë, me aspekt pak më ndryshe të vendosjes së prioriteteve, programeve dhe indikatorëve. Andaj, pjesëmarrës primarë në buxhetimin gjinor janë:

- **Nëpunësit shtetërorë** në organet e administratës shtetërore dhe në njësitë e vetadministrimit lokal të cilët gjatë hartimit të planeve dhe buxheteve strategjike në resorin e tyre duhet të mbajnë konsideratë për interesat edhe të meshkujve edhe të femrave sipas nevojave të tyre specifike. Interesat dhe prioritetet duhet të futen në programet dhe indikatorët e planeve strategjike, si dhe në programet dhe nënprogramet e buxhetit;
- **Qeveria** e cila duhet të shpreh dëshirë dhe angazhim të qartë politikë, ta pranojë dhe ta mbrojë qasjen gjinore gjatë përgatitjes dhe miratimit të buxhetit.
- **Deputetët** të cilët duhet t'i njohin segmentet gjinore në buxhet dhe të përpiqen t'i fusin nëse nuk janë në mbledhjet e komisioneve përkatëse të Kuvendit. Gjatë kohës së shqyrtimit të zërave të buxhetit, këta mund t'i pyesin kreatorët e politikave në institucione, në çfarë mënyre programet e tyre do të kenë ndikim të meshkujt dhe femrat dhe të rekomandojnë përfshirjen e perspektivës gjinore. Njëkohësisht, këta duhet të kërkojnë edhe ta nxisin ministrin e Financave të hartojë studim dhe arsyetim më të thellë për efektet dhe ndikimin e buxhetit në kategoritë e ndryshme të

grupeve (meshkujve dhe femrave), veçanërisht për zërat kryesorë të buxhetit.

- **Kryetarët e komunave** të cilët duhet të angazhohen për inkorporim të konceptit gjinor gjatë përgatitjes së buxhetit të njësisë së vetadministrimit lokal.
- **Këshilltarët në Këshillin e Vetadministrimit Lokal**, duhet të dinë ta njohin dhe ta inkorporojnë aspektin gjinor në politikat buxhetore të vetadministrimit lokal në fazën e përgatitjes së buxhetit të komunës, dhe gjatë kohës së mbledhjeve të komisioneve në Këshillë ta mbrojnë konceptin dhe të angazhohen që perspektiva gjinore të bëhet pjesë e buxhetit që do të dërgohet në miratim.
- **Koordinatorët për mundësi të barabarta të meshkujve dhe femrave në pushtetin qendror dhe në njësitë e vetadministrimit lokal**, të cilët në profesionalizimin e tyre nga sfera e mundësive të barabarta duhet t'u japin drejtime dhe t'u ndihmojnë institucioneve në procesin e përgatitjes së politikave, programeve dhe buxheteve.

Njëkohësisht, është e domosdoshme përfshirja edhe e të gjitha organizatave civile të prekura, partive politike dhe grupeve tjera joformale me aspektet e tyre, si dhe nga shkaku që disa nga të dhënat statistikore që na nevojiten për krijimin e prioriteteve, programeve dhe indikatorëve nuk janë çdoherë të arritshme. Andaj, që të mund buxhetimi gjinor që t'i pasqyrojë nevojat reale, përfshirjen e këtyre organizatave, të cilat më së miri e njohin sferën përkatëse dhe drejtpërdrejtë punojnë edhe me grupe të marginalizuara dhe të përjashtuara sociale të qytetarëve është e domosdoshme.

Njëherit roli i tyre në ndjekjen e konsistencës së politikave të Qeverisë dhe institucioneve është me rëndësi të madhe në ndërtimin e institucioneve përgjegjëse dhe të bilancit.

Faktorët që ndikojnë në kualitetin e buxhetimit gjinor

Edhe pse në esencë për konceptin e buxhetimit përgjegjës gjinor duhet të zhvillohet vetëdija për zbatimin e tij vullnetar, ekzistojnë edhe aspekte të caktuara të cilat duhet të jenë të pranishme me qëllim sa më saktë të krijohen programet dhe indikatorët. Me rëndësi të madhe është prezenca e faktorëve vijues për çështjet gjinore që të bëhen pjesë integrale e politikave të shtetit:

- Ekzistimi i dëshirës politike për arritjen e barazisë ndërmjet meshkujve dhe femrave në të gjitha nivelet në jetën publike.
- Ekzistimi i të dhënave statistikore të ndara gjinore për shkak të sigurimit të indikatorëve operativë në bazë të së cilës do të mund të matet veprimi dhe efikasiteti i politikës së buxheteve publike mbi meshkujt dhe femrat.
- Ekzistimi dhe marrja parasysh e hulumtimeve / studimeve analitike gjinore në të cilat identifikohen dallimet dhe ekzistimi i rasteve të jobarazisë gjinore;
- Përfaqësimi më i madh i femrave në trupat dhe proceset e miratimit të vendimeve në të gjitha nivelet në jetën shoqërore dhe politike;
- Ekzistimi i strukturave dhe mekanizmave të fuqishme dhe të përgatitura nacionale që do të bëjnë mbikëqyrje dhe do të angazhohen për zbatim të këtyre strategjive;
- Qasja e lirë te informatat me karakter publik.

Mungesa e këtyre faktorëve nuk do të thotë se buxheti gjinor është i pamundur të realizohet. Përkundrazi, ky proces imponon që së pari të fillohet me analizën e programeve dhe indikatorëve nga aspekti gjinor, e cila analizë duhet të tregojë se cilat informata, procese dhe ndryshime tjera duhet të bëhen që të fitohet buxheti senzitiv gjinor kualitativ. Metodrat dhe mjetet që janë prezantuar më tutje në doracak i ngritin këto ndryshime, të cilat mes tjerash, janë edhe qëllimet e këtij doracaku.

Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe plani strategjik

Buxheti i RM-së

Me pak fjalë, buxheti është një plan i të hyrave dhe shpenzimeve publike. Nëse të ardhurat publike tregojnë prej ku qeveria ka në plan ti financojë aktivitetet e saja, shpenzimet publike tregojnë në çka do të shpenzohen paratë. Prej kësaj, buxheti reflekton prioritetet dhe politikat e një qeverie.

Buxheti i RM-së përbëhet nga *pjesa e përgjithshme, e veçantë dhe e zhvillimit*.

Pjesa e përgjithshme përmban të hyrat totale, të hyrat tjera, shpenzimet dhe të dalurat tjera të buxhetit për vitin fiskal, si dhe parashikimet globale e të ardhurave, të hyrat, shpenzimet dhe të dalurat për dy vitet e ardhshme dhe të dhëna tjera.

Pjesa e veçantë përmban plan të mjeteve të miratuara të përdoruesve të buxhetit dhe fondet nga programet, nën-programet dhe artikujt për vitin fiskal.

Pjesa e zhvillimit përmban planet e programit të zhvillimit të buxhetit të përdoruesve të cilët u referohen projeksioneve afatmesme të mjeteve të miratuara. Megjithatë, duhet të cekim se plani për programet për zhvillim rishikohet çdo vit.

Për qëllimet e planifikimit gjinor, veçanërisht e rëndësishme është të theksohet struktura e shpenzimeve, sipas qëllimit të tyre dhe burimeve.

- Sipas **klasifikimit ekonomik** (projektimi një vjeçar) - ata janë të ndarë në *Shpenzimet aktuale*: pagat dhe përfitimet e punonjësve të administratës publike, shpenzimet materiale për të blerë materiale, mobilje dhe nevoja të ngjashme për punën në administratë, mallrat dhe shërbimet, kostot reserve dhe të padefinuara, transferet aktuale në fondet ekstra-buxhetore të njësive të vetqeverisjes lokale, pagesat e subvencioneve të interesit dhe përfitimet e mirëqenies; *Shpenzimet kapitale*: ndërtimi i ndërtesave, blerja e pajisjeve, ndërtimi i infrastrukturës, shpenzimet për hulumtim dhe zhvillim; *Shpenzime të tjera*: pagesën kryesore të

kreditorëve rezidentë, institucionet vendase dhe nivelet tjera të qeverisjes.

- Sipas **përdoruesve të buxhetit** (projektimi një vjeçar) - shpenzimet janë të ndara në bazë të secilit institucion veç e veç dhe në kuadër të institucionit (përdorues individual të buxhetit)
- Shpenzimet sipas **klasifikimit funksional** (projektimi një vjeçar) – janë paraqitur shpenzimet sipas qëllimit (arsimi, mbrojtja sociale, bujqësia) dhe jep informacion për shpërndarjen sektoriale.
- Shpenzimet sipas **programeve të qeverisë dhe projekteve kapitale** (projektimi tre vjeçar)

Klasifikimi me programet dhe projektet e qeverisë është jashtëzakonisht i rëndësishëm për buxhetimin përgjegjës gjinorë, veçanërisht pjesa ku në mënyrë **përshkruese** shpjegohen shpenzimet për secilën prej këtyre ndarjeve buxhetore. Ajo u fut në vitin 2009 dhe në një farë mënyre e bën një pjesë të buxhetit programor, në krahasim me të deritanishmin linear.

Buxheti i Republikës së Maqedonisë – Linear apo programor

Sipas strukturës aktuale të buxhetit të Republikës së Maqedonisë, i njëjti nuk mund të thuhet se është buxhet plotësisht linear ose i orientuar sipas programit. Në strukturën e saj përfshin elemente të të dy llojeve. Procedura buxhetore ofron buxhetimin me programe. Aktivitetet e mbuluara nga programet përcaktohen në Planet strategjike tre-vjeçare të cilat bëhen nga përdoruesit e buxhetit. Planifikimi strategjik siguron një përkufizim të indikatorëve për nivelin e çdo programi / projekti dhe komponentëve të tyre. Këto karakteristika të buxhetit theksojnë buxhetin e orientuar programor.

Megjithatë, brenda kornizave të çdo programi, kostot planifikohen në shpenzimet e artikujve. Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e përdoruesve të buxhetit në buxhetet e tyre kanë paraparë vetëm një program i cili mbulon të gjitha aktivitetet do të thotë se edhe kostoja planifikohet në grup me shpenzimet e artikujve, e cila paraqet buxhetimin linear.

Për arritjen e buxhetimit të plotë programor është e nevojshme:

- Theksi të vendoset jo në shpenzimet, por në programet
- Shpenzimet nga programet dhe aktivitetet, e jo nga kategoria e shpenzimeve
- Të përfaqësohet shuma totale e shpenzuar dhe nivelet e arritjeve
- Të ipet tregim narrativ i programit, të përcaktohen standardet e të arriturave dhe të udhëhiqen statistikat e të dhënave
- Qëllimet e vendosura të përmbushen

Pavarësisht mangësive të identifikuara, Republika e Maqedonisë është në rrugën e drejtë për të futur plotësisht buxhetimin programor. Si mbështetje e këtij pohimi është fakti se dokumentacioni i cili përdoret në buxhetimin e programit duhet tu përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- Pse ekziston përdoruesi buxhetor – objektivat dhe misioni
- Cilat rezultate përpiqet për t'i arritur përdoruesi i buxhetit - objektivat strategjike
- Çfarë bën përdoruesi i buxhetit për t'i arritur rezultatet - programet dhe objektiva operative
- Sa ajo vlen - mjetet që janë të nevojshme për përdoruesin e buxhetit për t'i arritur objektivat e tij të ndara sipas programeve dhe kategorive ekonomike
- Si maten rezultatet të asaj që zbatohen – indikatorë për matjen e të realizuarave
- Kush është përgjegjës për programin – personi përgjegjës

Duke analizuar dokumentacionin i cili paraqitet në interes të Qarkoreve buxhetore, mundet lirisht të konkludohet se e njëjta, më shumë ose më pak, jep përgjigje për shumicën e këtyre pyetjeve.

Procesi i miratimit të buxhetit

Bazat për përgatitjen e buxheteve janë:

- Prioritetet strategjike të Qeverisë së RM-së
- Strategjia fiskale
- Kërkesat e propozuara buxhetore nga përdoruesit e buxhetit
- Hartimi i Planeve Strategjike të përdoruesve të buxhetit dhe politikave buxhetore
- Prioritetet e komunave.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë përcakton prioritetet strategjike për vitin e ardhshëm, më së vonti deri në 15 prill të vitit aktual. *Prioritetet strategjike* si përmbledhje e qëllimeve dhe iniciativave, përdoruesit e buxhetit në qeverinë qendrore dhe fondeve, detyrueshëm i përfshijnë në buxhetet e tyre nëpërmjet programeve të qeverisë dhe nënprogrameve.

Bazuar në *strategjinë e miratuar fiskale* dhe sasishtë e vendosura maksimale të mjeteve të miratuara Ministria e financave më së vonti më 15 qershor, për përdoruesit e buxhetit të pushtetit qendror dhe fondeve, paraqet instruksione në formë të Qarkores Buxhetore për dorëzimin e aplikimit të përgatitjes së propozimeve të buxhetit.

Qarkorja përmban elementet e mëposhtme për përgatitjen e propozimeve për buxhet: projektimin e agregatëve makroekonomik të përmbajtura në strategjinë e miratuar fiskale; përcaktohen prioritetet strategjike të Qeverisë së RM-së me propozim të programeve aktuale dhe nënprogrameve të qeverisë, shumat maksimale të mjeteve të miratuara të shfrytëzuesve të buxhetit të përcaktuara nga Qeveria e RM-së; udhëzimet dhe drejtimet për përgatitjen e propozimit të kërkesave buxhetore, plani për zhvillimin e programeve dhe plani për vende pune të sistemuara dhe të plotësuara dhe informacione të tjera të nevojshme.

Propozimet e kërkesave buxhetore (përgatitur në bazë të elementeve të shënuara në qarkore) i dorëzojnë në Ministrinë e financave më së voni deri më 1 shtator të vitit aktual.

Ministria e financave i përpunon kërkesat dhe e paraqet buxhetin e propozuar për miratim gjer tek Qeveria e RM-së. Pas miratimit nga ana e Qeverisë i njëjti paraqitet për miratim në Kuvend sipas dinamikës së dhënë më poshtë.

Rëfim skematik i përgatitjes së buxhetit

Aktivitet	Afati i fundit
Prioritetet strategjike të Qeverisë	deri 15 prill
Projektimi i agregatëve makroekonomik (Strategjia fiskale)	deri 15 prill
Qarkorja buxhetore	deri 15 qershor
Kërkesa e propozuar buxhetore	deri 1 shtator
Qeveria e RM-së e miraton buxhetin	deri 1 nëntor
Qeveria e RM-së e dorëzon buxhetin e propozuar në Kuvend	deri 15 nëntor
Kuvendi e sjell buxhetin	deri 31 dhjetor

Korrelacioni i planeve strategjike dhe buxhetit

Pas miratimit të vendimit për prioritetet strategjike dhe miratimit të strategjisë fiskale, ministrinë dhe organet tjera të administratës shtetërore fillojnë me përgatitjen e plan projektit strategjike projekt. Planet strategjike përpunohen në vitin aktual, në periudhën nga maji deri në gusht dhe vlejné gjatë tre viteve të ardhshme. Ato i përmbajnë objektivat dhe detyrat e njësisë organizative dhe të përdoruesve të buxhetit në përgjithësi, aktivitetet për të arritur këto objektiva, si dhe efektet dhe rezultatet e të njëjtave. Përgatitur në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë së RM-së, dhe në aspektin e sistemit të integruar dhe të buxhetimit, Plani strategjik është një dokument shoqëruar i kërkesave buxhetore.

Pjesa e fundit e Planeve Strategjike është Plani i zbatimit në të cilin janë të cekura programet të cilat i zbaton përdoruesi i buxhetit i përfaqësuar nga rezultatet e pritura, aktivitetet që do të zbatohen, indikatorët me të cilat do të matet realizimi, resurset e nevojshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e të njëjtave, mbajtësit e aktivitetet dhe afatet për realizimin e tyre.

Në Planin e zbatimit, është e shfaqur lidhja e programeve me prioritetet strategjike dhe objektivat e Qeverisë së RM-së dhe të atyre të përdoruesve të buxhetit, si dhe objektivat, rezultatet dhe treguesit për suksesin e programit dhe në cilin program buxhetor përkasin. Në plan janë inkorporuar programet, nën-programet dhe projektet në funksion të realizimit të prioritetëve strategjike të qeverisë. Planet e programeve për zhvillim janë gjithashtu pjesë e Planeve strategjike.

PIKAT HYRËSE PËR FILLIMIN E PROCESIT TË BUXHETIMIT TË PËRGJEGJËS GJINOR

Duke pasë parasysh strukturën e tanishme të buxhetit dhe planet strategjike, ekzistojnë më shumë mundësi për futjen e buxhetimit të përgjegjës gjinor.

Dokumentet e mëposhtme janë identifikuar si pika hyrëse:

- Planet strategjike;
- Programet e propozuara të projekteve për zhvillim; dhe
- Qarkorja buxhetore, si dokumentet themelore; dhe
- Programet qeveritare, programet buxhetore, prioritetet strategjike dhe objektivat si prioritetet strategjike të Qeverisë.

Programet qeveritare, prioritetet dhe objektivat strategjike

Kur bëhet fjalë për përfshirjen e aktiviteteve lidhur me përfshirjen e perspektivës gjinore në rrjedhat shoqërore që do të financoheshin nga buxheti i RM-së, analiza duhet të fillojë me rishikimin e programeve qeveritare dhe prioritetëve strategjike, sepse siç është përmendur tashmë ajo është hapi i parë drejt përcaktimit të aktiviteteve të financuara nga buxheti b RM-së. Programet qeveritare në sektorë të ndryshëm ndikojnë në mënyra të ndryshme tek burrat dhe gratë, në fuqinë e tyre ekonomike dhe standardin e jetesës.

Shembull:

Gjinia josenzitive

Programi i qeverisë - Masat për rritjen e punësimit dhe standardit të jetesës,

Prioritet – zmadhimi i rritjes ekonomike dhe konkurrenca në bazë të përhershme, normë më e lartë e punësimit, rritja e standardit të jetesës dhe cilësia e jetës

Objekti strategjik - Zbatimi i politikave aktive për punësim me të cilat vepohet mbi njohuritë dhe kualifikimet e ofertës së fuqisë punëtore.

Gjinia senzitive

Programi i qeverisë: Masa për rritjen e punësimit dhe standardet e jetesës të burrave dhe grave;

Prioritet: zmadhimi i rritjes ekonomike dhe konkurrenca në bazë të përhershme, normë më e lartë e punësimit të burrave dhe grave, rritja e standardit të jetesës dhe cilësia së jetës të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave;

Objekti strategjik: Zbatimi i politikave aktive të punësimit të burrave dhe grave, me të cilat vepohet në njohuritë dhe kualifikimet e ofertës së fuqisë punëtore;

Shënim: Rëndësia e kategorive të ndryshme të përdoruesve, në këtë rast duke shtuar fjalët “gra dhe burra” është hapi i parë drejt integritit të perspektivës gjinore. Ky është vetëm një drejtim i cili duhet të na kujtojë, se politikat e punësimit duhet të jenë të përshtatme me analizën e situatës të burrave dhe grave në tregun e punës, kurse indikatorët të jenë të definuar në mënyrë në të cilën do ti masin rezultatet, efektet dhe ndikimet e ndërhyrjes të burrave dhe grave. Pra, nëse me masat e parashikuara presim të mbulojmë 40% të grave, menjëherë parashtrohet pyetja cilat gra janë grupi ynë i synuar: të reja, gra nga minoritetet etnike (dhe përsëri nga cilat grupe etnike) nga mjedisi urban dhe rural etj. Pse? Përderisa i njohin dallimet që ekzistojnë midis kategorive të ndryshme të përdoruesve, nën ndikimin e faktorëve politik, social, psikologjik dhe faktorëve tjerë, do të mund ti përshtatim intervenimet tona dhe aktivitetet në mënyrë që do të sigurojnë suksesin më të mirë në realizimin e intervenimeve.

Programet e tilla të përcaktuara, prioritetet strategjike dhe objektivat e Qeverisë së RM-së do të kontribuojnë në definimin e aktiviteteve specifike (projekte) nga përdoruesi buxhetor të cilat do të jenë të ndjeshme nga ana gjinore dhe do të jenë të përshtatura për nevojat e qytetarëve.

Prioritetet i shprehin rezultatet e përgjithshme të cilat duhet të arrihem në afat të mesëm dhe të gjatë. Futja dhe shprehja e komponentit gjinorë si pjesë e rezultatit të përgjithshëm në prioritetin konkret është e dëshirueshme, me atë që në objektivat strategjike të komponentit gjinorë do të zhvillohen nëpërmjet rezultateve konkrete, specifike, realiste me një kornizë të caktuar kohore. Nga objektivat e caktuara qartë dhe indikatorëve, bazuar në analizën gjithëpërfshirëse, do të jetë më lehtë të caktohen mjetet e duhura buxhetore dhe të ndiqet shkalla e zbatimit të tyre.

Plani Strategjik, Propozim i planit të programeve për zhvillim dhe Qarkorja buxhetore.

Në procesin e planifikimit strategjik të përdoruesve të buxhetit duhet t'i identifikojnë projektet, përkatësisht aktivitetet nga kompetencat e tyre të cilat kanë kontakt me përfshirjen e perspektivës gjinore në rrjedhat shoqërore. Kur njëherë këto aktivitete do të jenë të identifikuar, të njëjtat duhet të vërehen në Planin strategjik, Planet e programeve për zhvillim dhe Qarkorja buxhetore.

Në këto dokumente detyrueshëm duhet të përcaktohen **aktivitetet senzitive gjinore dhe indikatorët**, përmes të cilave do të maten rezultatet e aktiviteteve të zbatuara. Indikatorët e ndjeshëm gjinorë duhet të ndahen sipas: gjinisë, përkatësisë etnike, moshës, arsimit, vendbanimit dhe ngjashëm. Me këtë përkufizim të aktiviteteve dhe indikatorëve do të lejohet monitorimi më i afërt i efekteve nga të njëjtat përmes monitorimit dhe analizës së indikatorëve të ndjeshëm gjinorë të cilët do të definoohen me krijimin e Planeve strategjike, Planet e programeve për zhvillim dhe Propozimin e kërkesës buxhetore.

Çfarë është indikatori sensitiv gjinorë

Ekzistojnë katër kritere me të cilat mund të përcaktohet nëse ndonjë indikator është sensitiv gjinorë:

1. Nëse është ndarë sipas gjinisë. Shembull: përqindja / numri i atletëve meshkuj dhe atletëve femra
2. Nëse direkt është i synuar kah burrat apo gratë. Shembull: Përqindja e grave me pozitë udhëheqëse në administratën shtetërore nga numri i përgjithshëm i udhëheqësve
3. Nëse konteksti më i gjerë nënkupton relevantën specifike për gratë dhe burrat. Shembull: Numri dhe përqindja e viktimave të dhunës në familje (indikatori nënkupton numrin e femrave, sepse në shumicën e rasteve ato janë viktimat e dhunës në familje)
4. Indikator është zgjedhur nga gratë (burrat). Shembull: numri i grave që kanë qenë të informuara për projektin e ministrisë që atyre iu intereson. (Ky indikator nuk është e detyrueshme tu dedikohet grave apo burrave në përgjithësi. Me vet atë që është zgjedhur nga burrat ose gratë, për të ka interes nga ana e tyre dhe është relevante).

Identifikimi i projekteve/aktiviteteve të ndjeshme gjinore dhe indikatorët në **Planin Strategjik** më e përshtatshme është të shtohen në Planin e zbatimit, përkatësisht në seksionin "rezultatet e pritura (komponente) programore", ku shfletohen projektet e planifikuara dhe aktivitetet të cilat shfrytëzuesit e buxhetit synojnë ti përmbushin në periudhën e ardhshme, si dhe indikatorët sipas të cilëve do të matet arritja e tyre.

Sa i përket **Planit të programeve zhvillimore**, seksioni në të cilën përshkruhen objektivat e programit të zhvillimit është më e përshtatshme të përdoret për tu shpjeguar nëse dhe si programi do të kontribuojë në integrimin e aspekteve gjinore në rrjedhat


shoqërore. Përderisa projekti përmban një komponentë gjinore detyrueshëm në seksionin e indikatorëve të definohej edhe indikatorët e ndjeshëm gjinorë.

Në **buxhetin qarkor**⁴, formularët A2 dhe A3, dhe sidomos formularët C1 dhe C2 kanë rëndësi për buxhetimin e programit të orientuar. Këto formularë e definojnë klasifikimin programik të buxhetit dhe në to përshkruhen programet e shfrytëzuesve të buxhetit (Formulari A2), programet qeveritare (Formulari A3) dhe projektet e zhvillimit (Formulari C1 dhe C2). **Formulari i buxhetit kërkon edhe identifikimin e indikatorëve output përmes të cilit përdoruesit e buxhetit duhet ta identifikojnë aspektin gjinorë në këto formularë, si dhe për të njëjtat detyrueshëm të përcaktojnë indikatorin e ndjeshëm gjinorë të cilat janë të ndara në mënyrë gjinore me qëllim të mundësojnë matje të efektivitetit dhe ndikim të programeve mbi burrat dhe gratë.**

Megjithatë, buxhetimi gjinorë është një proces që nuk përfundon me identifikimin e pikave hyrëse. Jashtëzakonisht e rëndësishme është të shfrytëzohen pika hyrëse për të integruar konceptin e buxhetimit të përgjegjës gjinorë. Prandaj është e nevojshme që të vazhdohet me zhvillimin e kapaciteteve në korniza të administratës për zbatimin e saj. Mjetet e paraqitura në kapitullin e ardhshëm ofrojnë pasqyrë të qartë të hapave të cilat duhet të ndërmerren dhe aspektet për të cilat duhet të kujdesemi pranë analizës buxhetore me qëllim krijimin e buxhetit të përgjegjës gjinorë. Të njëjtat duhet të kontribuojnë në ndërtimin e kapacitetit administrativ për buxhetimin e përgjegjës gjinorë dhe të kontribuojnë në ndërtimin e institucioneve në drejtim të përmirësimit të sistemit të mbledhjes së të dhënave, vendosjen e bashkëpunimit ndër-sektorial dhe ndër-ministor, rritjen e vetëdijes për rëndësinë dhe përfitimet nga analizat gjinore dhe në përgjithësi për përfshirjen e gjinisë në rrjedhat shoqërore.

⁴ Shembull i buxhetit qarkor, shtesa 2

Pikat kryesore për zbatimin e konceptit të buxhetimit përgjegjës gjinor në procesin e planifikimit strategjik dhe përpunimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë



METODAT DHE MJETET PËR BUXHETIMIN GJINOR

Pas përcaktimit e pikëve hyrëse për buxhetimin përgjegjës gjinor në procesin e krijimit të buxhetit dhe prioritetet strategjike dhe planet e Qeverisë, në këtë kapitull janë paraqitur praktikat më të mira aktuale në zbatimin e analizës së buxhetimit gjinor dhe buxhetimin gjinor.

Megenëse ky doracak synon kryesisht për nëpunësit shtetëror, këto mjete skicojnë kapat se si nëpunësit shtetëror mund të punojnë në buxhetimin gjinor të përgjegjshëm. Sigurisht se mjetet e njëjta mund të përdoren edhe nga të gjithë aktorët e tjerë në procesin e buxhetimit gjinor të përgjegjshëm të cilët veç më i identifikua më lartë në këtë doracak.

Gjatë përgatitjes së buxheteve, përgjithësisht formulohen tre nivele të vendimeve:

- Nëse deficiti ose suficiti është në kufijtë sipas politikës makroekonomike
- Nëse struktura e të hyrave dhe të dalave është përkatëse
- Nëse sektori publik mundëson nivelin e kërkuar dhe llojin e shërbimeve të ndërmarrjeve, qytetarëve dhe komuniteteve

Mjetet e paraqitura më poshtë mundësojnë integrimin e buxhetimit gjinor të përgjegjshëm në të tre nivelet. Këto mund të shfrytëzohen individualisht apo në kombinim, në varësi të rastit të veçantë dhe sigurojnë përndarje më të barabartë të efekteve dhe përfitimet për burrat dhe gratë e Politikave qeveritare.

MJETET PËR ANALIZËN PËRGJEGJËSE GJINORE

Analizë buxhetore gjinore si një hap drejt buxhetimit gjinor mund të bëhet në mënyra të ndryshme duke përdorur modele të ndryshme analitike apo mjete, sikurse në anën shpenzuese ashtu edhe në atë hyrëse të buxhetit.

Në këtë pjesë janë paraqitur gjashtë mjete më të zakonshme (instrumente) me të cilat mund të kryhet analiza gjinore e buxheteve. Për shkak të thjeshtimit, çdo mjet fillon me një pyetje kyçe, pastaj është dhënë përshkrimi i mjetit dhe një shembull mbi zbatimin e tij.

Megjithatë, pyetje kyçe në analizën sensitive gjinore të buxhetit është nëse mjetet arrijnë deri tek ata që kanë nevojë dhe qëllim. Në të njëjtin drejtim, nëse politika ekonomike e qeverisë dhe instrumentet reduktojnë apo rrisin pabarazinë gjinore.

1. Vlerësimi sensitiv gjinor i politikës

Pyetja kyçe: Deri në çfarë mase ministritë, në mënyrë eksplicite apo implicite, i kushtojnë kujdes pyetjeve të gjinisë? Nëse me këtë rast politika e tyre dhe mjetet me të cilat me të cilat disponojnë ndaj reduktimit, përkatësisht rritjes së pa barazisë? Analiza sensitive gjinore e buxhetit fillon me supozimin se buxhetet duhet ndjekur politikën. Nëse buxhetet ndjekin politikën me një mjet me mjetin e vlerësimit sensitiv gjinor të politikës mund të identifikohen mangësitë dhe përkufizimet e vetë politikës si dhe mjaftueshmëria e alokimeve buxhetore. Në këtë mënyrë, në fakt vendoset një lidhje e drejtpërdrejtë në mes të politikës e cila zbatohet dhe alokimeve buxhetore. Për dallim nga disa mjete tjera kjo qasje

analitike në masë të madhe ka të bëjë me vlerësimin e politikës në tërësi.

Megjithatë me përdorimin e këtij mjeti është shumë e vështirë që të përcaktohet se cilët janë individët ose grupet të cilët drejtpërdrejtë ishin të përfshirë apo kanë dobi nga alokimet buxhetore. Për shembull, politikat qeveritare parandaluese shëndetësore kanë një efekt shumë të gjerë. Megjithatë, shumë përkatëse është çdo politikë dhe brenda kornizave të saja të gjitha strategjitë dhe programet që rrjedhin prej saj të analizohen në aspektin e ndikimit të tyre mbi çështjet gjinore (mënyrën në të cilën fushatat shëndetësore kanë të bëjnë me nevojat e ndryshme shëndetësore të grave dhe burrave).

Vlerësimi sensitiv gjinor i politikave në fakt shënon analizë e cila reflekton implikimet gjinore të politikës në raport të:

- identifikimi i çështjeve gjinore direkte dhe indirekte;
- identifikimi i alokimeve buxhetore të lidhura me politikën përkatëse dhe
- vlerësim nëse politika do të vazhdojë ose do të ndryshojë pabarazitë ekzistuese ndërmjet grave dhe burrave (dhe grupet e ndryshme të grave dhe burrave) dhe ekzistojnë modele gjinore.

Në kohën e reformës së tokës në Afrikën e Jugut, janë ofruar paketa kompensimi dhe kreditë për mikrofinancimin e transformimit të pronësisë së tokës. Gjatë vlerësimit të kësaj politike në aspektin gjinor, janë konstatuar më shumë faktorët rëndues që i vënë gratë në një pozitë të pabarabartë. Kështu, përfitimi i këtyre masave për gratë është penguar për shkak se qasja e tyre ishte pranë parcelave më të vogla dhe si shtesë se gratë të cilat janë kujdesur për familjet zakonisht kishin më pak financa në dispozicion.

Konkluzioni i analizës ishte se gratë nuk kishin mundësinë t'i shfrytëzojnë të mirat e kësaj politike në të njëjtën masë si burrat. Përgjigja për këtë është që të përfshihet aspekti gjinor

në sistemin e vlerësimit dhe monitorimit në përzgjedhjen e përfituesve si dhe organizimi i trajnimeve për nëpunësit e institucioneve shtetërore të përfshira në këtë proces.

2. Vlerësim i ndarë gjinor i shfrytëzuesve

Pyetje kyçe: Cilat janë qëndrimet e shfrytëzuesve ekzistues dhe potencial rreth asaj se, sa dhe nëse programi qeveritar përkatës apo politika reflekton prioritetet dhe nevojat e tyre?

Ky mjet mundëson të dëgjohet zëri i qytetarëve. Duke përdorur teknika të ndryshme, shfrytëzuesit ekzistues ose potencial të një programi të veçantë janë pyetur për qëndrimet e tyre nëse shërbimet publike reflektojnë prioritetet tyre. Këto përgjigje janë analizuar në mënyrë që të vlerësohet nëse buxheti i qeverisë ekzistuese është në përputhje me nevojat e grave dhe burrave. Në thelb, Dijana Elson ekonomiste britanike feministe thotë se gratë dhe burrat që marrin pjesë në hulumtim duhet të pyeten: "Si do ta ndanin kek-un kombëtar buxhetor, në qoftë se ata do të ishin Ministër i Financave"?

Të dhënat mbi vlerësimin e ndarjes gjinore të shfrytëzuesve mund të merren përmes hulumtimit kuantitativ (hulumtim i opinionit publik ose studim i qëndrimeve) ose proceset kuantitative (fokus grupe, intervista, etj.), të cilat mund të zbatohen sikurse nga institucionet qeveritare ashtu edhe nga organizatat e qytetarëve.

Në SHBA në vitet e 90-ta, si rezultat i krizës së borxhit dhe deficitit buxhetor filloi me shkurtrimin e shpenzimeve, me qëllim që të reduktohet deficitin. Me këtë shkurtrim Lidhja

ndërkombëtare e grave për paqe dhe liri bërë një pyetësor mbi prioritetet mbi të cilat gratë do t'i alokonin mjetet me një fokus të shpenzimeve ekzistuese për ushtrinë. Kjo ishte arsyeja që mjetet për këtë qëllim ishin të mëdha, ndërsa gratë ishin përfaqësuar në ushtri dhe nuk ishin të lidhura me punët kontraktuese që janë kryer për ushtrinë. Kështu shpenzimet ushtarake janë krahasuar me transferet sociale me pyetjen "çfarë do të kishit zgjedhur ju". Rezultati ishte që të reduktohen shpenzimet për objektivat e ushtrisë dhe ushtarakëve dhe të njëjtat të drejtohen në favor të grave. Kjo përfshinte programe dhe trajnime për punësimin e grave, fushata kundër dhunës me bazë gjinore, shërbime për të moshuarit (në këtë grup, shumica ishin gra).

3. Analiza e ndarjes së të dalave gjinore publike

Pyetje kyçe: Nëse shpenzimet publike janë me përfitim të barabartë për burrat dhe gratë?

Analiza e ndarë gjinore e shpenzimeve publike bëhet në bazë të të dhënave statistikore për familjet, për natyrën e shpenzimeve të cilat i siguron sektori publik dhe shpërndarja e tyre të burrave dhe grave. Ky mjet mund të përdoret për të vlerësuar shpërndarjen e shpenzimeve qeveritare për një program të veçantë ndërmjet grave dhe burrave. Për shembull, ky mjet mund të përdoret për të krahasuar shpenzimet e politikave aktive të punësimit, të cilat ishin objekt i analizës gjinore të buxhetit⁵ dhe të shihet se cilët ishin shfrytëzuesit dhe se si janë shpërndarë mjetet. Gjithashtu, mund të krahasohen shpenzimet në fusha të ndryshme në lidhje me nevojat specifike gjinore që janë paraqitur në

⁵Analiza gjinore e buxhetit e mbrojtjes sociale dhe politikave aktive të punësimit në RM-së, MPSS

hulumtim. Vlerësohet shpenzimi i vetëm i shërbimit dhe më pas shumëzohet me numrin total të shfrytëzuesve, për shembull burrat dhe gratë. Në këtë mënyrë llogaritet shpenzimi total për çdo kategori të shfrytëzuesve të një programi të veçantë. Në fund mund të shihet se për cilat grupe të shfrytëzuesve Qeveria shpenzoi pjesën më të madhe të mjeteve, dhe me këtë kush kishte dobi më të madhe nga programi përkatës. Ky mjet kërkon të dhëna të plota kuantitative që të mund të merret një vlerësim solid i njësisë së shpenzimit për shfrytëzues ose për familje.

Përvojat tregojnë se, edhe pse çdo Qeveri duhet të vlerësojë shërbimet që ajo ofron dhe të identifikojë shfrytëzuesit e programeve të tyre. Megjithatë, problem më të madh paraqet mungesa e të dhënave statistikore dhe të ndara – gjinore për shpërndarjen e shpenzimeve publike.

Analiza gjinore ndarëse e shpenzimeve publike, metodë e fuqishme analitike, megjithatë kjo nuk i merr parasysh dallimin ndërmjet matjes së shpenzimeve financiare të shërbimeve të caktuara dhe matjen e ndikimit social.

Në ndryshimet në programin e subvencioneve dhe ndihmës financiare për familjet e varfra, pavarësisht rritjes ekonomike, në fakt vlera e subvencioneve dhe ndihmave ushqimore u reduktua. Me këtë është vërejtur rënie në të ardhurat reale në mesin e shfrytëzuesve, pra familjet e varfra. Analiza gjinore ndarëse e kësaj gjendje tregoi se në mes të familjeve, shfrytëzues të këtyre subvencioneve më të prekura ishin gratë dhe vajzat, duke vënë në dukje nivelin e lartë e të ushqyerit të pamjaftueshëm tek vajzat e moshës para-shkollore dhe shkollore. Gjithashtu, ky nivel i ulur i ushqimit çoi në një reduktim të peshës së foshnjave të porsalindura tek nënat me të ardhura më të ulëta.

4. Analiza e ndarjes gjinore së të hyrave publike

Pyetje kyçe: Sa tatim pagan individ, përkatësisht familjari dhe nëse lehtësimet tatimore janë të ndara në mënyrë të ndryshme për murrat dhe gratë?

Me këtë mjet hulumtohet ana e të hyrave të buxhetit, përkatësisht analizon tatimet direkte dhe indirekte si një burim i të hyrave buxhetore. Qëllimi i këtij rasti është që të zbatohet analiza e ndarjes gjinore e tatimit.

Politikat tatimore ndikojnë në mënyrë të ndryshme në kategoritë e ndryshme (burra dhe gra). Për shembull, vendosja e taksës së barabartë. Për shkak të dallimeve ekzistuese në paga midis burrave dhe grave, përqindje më e ulët e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe përqindje më e madhe e grave në vende të punës të paguara dobët, gratë mesatarisht kanë të ardhura më të ulëta se burrat. Sipas kësaj, më shumë burra do të kenë dobi nga vendosja e taksës së barabartë. Nga ana tjetër, më shumë gra do të përfitonin nga një rritje në pagën minimale. Për një analizë të tillë janë të nevojshme të dhëna për të hyrat dhe të dalat, matrice të cilat mund të marren nga analizat e familjeve. Kufizimi i kësaj analize është se ajo parashikon një shpërndarje të barabartë të të hyrave në familjet që në shumë studime dëshmon si e pasaktë.

Në Britaninë e Madhe, grupi i buxhetit të femrave është i fokusuar në ndihmat - mbështetja e tatimeve, varfërinë, pensionet, punën e kombinuar dhe kujdesin në shtëpi, pagat e barabarta dhe produktivitetin. Punët e mëposhtme janë bërë si rezultat i një analize të detajuar të situatës në fusha të caktuara në të cilën është i përfshirë buxheti gjinor:

- Mundësi për të marrë një kredi tatimore - shtetërore (ndihmë), e cila mundëson që çiftet e martuara të ndajnë orët e punës dhe të përkushtojnë kohë mbi kujdesin dhe edukimin e fëmijëve. Me këtë që ndryshimi nën një nivel të caktuar të të hyrave vjetore kompenson shtetin. Në këtë rast, të dy prindërit kujdesen për rritjet e fëmijëve.
- Mundësi për të marrë një kredi tatimore – shtetërore për prindin e cila kohë është e përkushtuar për rritjen e fëmijës / fëmijëve. Shteti paguan punën e prindit i cili kujdeset për fëmijët.

Është e rëndësishme të theksohet se këto ndryshime nuk janë bërë vetëm me argumentin e barazisë, por edhe me efikasitetin dhe produktivitetin. Analizat tregojnë se në rastet kur punëtorët të cilët janë të mbështetur nga këto masa, ishin më produktiv se sa mos të marrin asnjë mbështetje për kujdesin e fëmijëve, e cila në një numër më të madh të rasteve është lënë në pjesë më të madhe në nënën.

5. Analizë e ndarjes gjinore të buxhetit në aspekt të shfrytëzimit të kohës

Pyetje kyçe: Në çfarë mase buxheti mbështetet në punën e papaguar shtëpiake (kujdesi për pleqtë, të sëmurët, gatim, larje, etj)? Kush çfarë punon dhe si ndahet puna e papaguar në mes të grave dhe burrave?

Analiza e ndarjes gjinore të buxhetit në aspektin e shfrytëzimit të kohës, hulumton marrëdhëniet midis buxhetit kombëtar dhe shfrytëzimit të kohës në familje, me çka hulumtohet koha e kaluar në punë të papaguar. Për të zbatuar një analizë e tillë kërkohen të dhëna nga anketat ekzistuese për shfrytëzimin e kohës, të cilat duhet të zbatohen në nivel kombëtar nga institucionet statistikore, siç është rasti në Republikën e Maqedonisë. Pikërisht, në vitin 2004, Enti Shtetëror i Statistikës ka zbatuar anketa mbi shfrytëzimin e kohës (dhe në të ardhmen do të zbatohet çdo pesë vjet), me çka të dhënat, ndër tjerash u përgjigjën edhe në pyetjet se çka bëjnë gratë dhe burrat në kohën e tyre të lirë dhe sa kohë gratë mesatarisht në ditë kalojnë në aktivitetet shtëpiake se sa burrat. Të dhënat nga kjo anketë tregojnë se në R.M. midis burrave dhe grave ende është e pranishme ndarja tradicionale e punëve, sepse burrat një pjesë të madhe të kohës e kalojnë në punë të paguar, ndërsa në mesin e grave puna shtëpiake e papaguar merr pjesën më të madhe kohës (sipas kësaj ankete burrat shpenzojnë mesatarisht prej 1 orë., dhe 44 min. në ditë në aktivitetet e shtëpiake, për dallim nga gratë të cilat për të njëjtën gjë shpenzojnë 4 orë dhe 51 min.). Politikat që shkaktojnë ngarkesë në amvisëri/familje, si për shembull, reduktimi i shërbimeve spitalore shkakton një ngarkesë plotësuese në kohën e nevojshme për kujdesin e të sëmurëve.

Me reduktimin e shpenzimeve të buxhetit mbi një qytetarë në shëndetësi për 16% në Zambia dhe me këtë rënia e qasjes së shërbimeve shëndetësore, njerëzit duhej të kalonin një rrugë shumë të gjatë për të marrë trajtim në spitale dhe për të furnizuar ilaçet. Duke marrë parasysh faktin se femrat shpenzojnë më shumë kohë për kujdesin e anëtarëve të sëmurë të familjes , i cili përfshin kohën për sigurimin e ushqimit në spitale dhe kujdesi i drejtpërdrejtë, koha e tyre ishte më e prekur nga vendimi që të ndryshohen shpenzimet e buxhetit.

Me vendosjen dhe zbatimin e GDN (Grupe diagnostiko të ngjashme) modeli në Republikën e Maqedonisë, një nga ndryshimet më të rëndësishme ishte barazimi i kostos së shërbimeve të shëndetësore në të gjitha institucionet shëndetësore për grupet e njëjta diagnostike dhe për kompleksitetin e njëjtë. Si rezultat i këtyre ndryshimeve dhe shkurtimi i shpenzimeve, kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të pacientëve në spitale është reduktuar me atë se është rritur kujdesi shtëpiak.

Analiza¹ e cila është bërë në këtë drejtim, tregoi se pas lëshimit nga spitali, kujdesin e të sëmurëve në pjesë më të madhe e kryejnë femrat, anëtare të familjes, me arsye se kujdesi parësor shëndetësor, shërbimi i pleqve në shtëpi dhe shërimi shtëpiak janë të pamjaftueshme për të zëvendësuar kujdesin e anëtarëve të familjes . Raporti i kohës i cili shpenzohet për kujdesin shtëpiak është rreth 5 orë i grave kundrejt 2,5 orë për burrat.

Ky angazhim i grave, anëtare, nuk është i paguar dhe vlerësohet se vlen afërsisht 10.000 denarë në muaj. Kështu, edhe pse fondi me këtë reformë kursen rreth 34% të buxhetit, vendosja e këtillë e GDN modelit nuk është masë përgjegjëse gjinore në aspekt të shfrytëzimit të kohës.

¹ Analiza „Më shumë kujdes në shëndetësinë primare“ është bërë nga qendra për hulumtimin dhe krijimin e politikave me përkrahjen e Fondit të zhvilluar për gra pranë Kombeve të bashkuara (UNIFEM), në kuadër të programit rajonal për buxhetimin përgjigjës gjinor të financuar nga bashkëpunimi i zhvilluar Austrian

6. Formulimi në kuadër të politikës ekonomike afatmesme të ngjashme - gjinore

Pyetje kyçe: Si mund të definohen variablat e ndara gjinore? Në cilin drejtim janë duke u zhvilluar dhe ndryshuar supozimet ekzistuese në lidhje me funksionimin e shoqërisë, institucioneve dhe ekonomisë?

Formulimi në kuadër të politikës ekonomike afatmesme të ngjashme, si një qasje përfshin perspektivën gjinore në modelet makroekonomike. Kjo supozon matjen e ndikimeve të ndryshme gjinore në aktivitetet ekonomike të shtetit duke i përfshirë edhe indikatorët sensitivë gjinor.

Planifikimi ekonomik ka për qëllim që të vendoset perspektiva gjinore, përkatësisht të tejkalohet nocioni i perceptimit të të gjinisë asnjëse të modeleve themelore ekonomike. Këto janë disa nga mënyrat në të cilat perspektiva gjinore mund të inkorporohet në kornizat afatmesëm ekonomik, që ndikojnë në formulimin e buxhetit të ardhshëm:

- variabla të ndara gjinore aty ku të njëjtat mund të përdoren;
- përfshirje sikurse e të hyrave nacionale shtu edhe e të hyrave nga puna e pa paguar në amvisëri.


Qëllimi i këtij mjeti është që gjinia të integrohet në planet financiare dhe modelet ekonomike, me qëllim që të krijohen parakushtet për planet sensitive gjinore buxhetore, me çka do të ndikohet në reduktimin e pabarazive gjinore. Për këtë qëllim, duhet të merret parasysh edhe ekonomia e kujdesit dhe kujdesi si një faktor ekonomik. Përfshirja e ekonomisë së përkujdesjes dhe kujdeset si kategori ekonomike parashikojnë ekzistimin e të dhënave të ndara sipas gjinive, përcaktimin e të hyrave nacionale dhe të hyrat buxhetore, duke marrë parasysh punën e papaguar dhe ndryshimin e supozimeve

themelore të bazave sociale dhe institucionale të shoqërisë, duke përfshirë ato në lidhje me mënyrën se si funksion ekonomia.

Planifikimi afatmesëm ekonomik bëhet në dy nivele. Në një nivel të përgjithshëm, ky është krijimi i ekonomisë së përgjithshme, e cila përfshin variablat në vijim: shkalla e rritjes ekonomike, deficitit buxhetor, inflacioni, norma e interesit dhe punësimi. Në një nivel më të detajuar, planifikimi është bërë në formën e një alokimi buxhetor në lidhje me shpenzimet totale buxhetore të projektuara në planifikimet e përgjithshme. Për shembull, në arsim, planifikimi do të bëhet në bazë të projektimit të numrit të nxënësve, apo në shëndetësi, duke u bazuar në numrin e projektuar të pacientëve në shëndetësinë publike ose numrin e vizitave në një pacient. Këto variabla mund të jetë subjekt i analizës gjinore.

Planifikimi afatmesëm ekonomik (buxhetimi) është i një rëndësie të madhe për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor të suksesshëm që efektet e disa prej masave shihen në afat të mesëm dhe të gjatë. Më shumë përvoja tregojnë se reduktimi i shkallës së fertilitetit të gratë nëpërmjet rritjes së shkallës së arsimimit do të jep një efekt të rëndësishëm për një periudhë më të gjatë i.e ashtuquajtur, deri sa gratë janë në gjendje të ngelin shtatzëna. Prandaj është shumë me rëndësi që masat e buxhetimit gjinor të hyjnë në planet e parapara prej 3-5 vjet të shpenzimeve buxhetore.

**SI DERI NË POLITIKAT PËRGJEGJËSE GJINORE,
STRATEGJITË DHE BUXHETET – QASJE NË PESË HAPA**



Në fund, në përpjekje që të lehtësojmë procesin e përgatitjes së çështjeve gjinore politike, programeve dhe buxheteve ju paraqesim qasjet dhe hapat më shpesh të shfrytëzuara me të cilat kryhet procesi i krijimit, ndjekjes dhe vlerësimit të politikave dhe buxheteve në administratën publike dhe më gjerë.

Hapat e përshkruara më poshtë dhe pyetjet kyçe të cilët duhet që t'i vendosni janë një nga metodat analitike më të përdorura të vendosura nga Dijana Elson të cilat këto metoda i ka zhvilluar për nevojat e Federatës Britanike.

Ne shpresojmë që këto udhëzime do t'i ndihmojnë administratës të jenë më të përgjegjshme për çështjet gjinore dhe të jenë të vetëdijshme për efektin dhe ndikimet e politikave dhe buxheteve ndaj jetës së burrave dhe grave, tani dhe në të ardhmen

1. Analizë e situatës në raport me gratë dhe burrat në sektorin e dhënë

Siç u theksua më sipër, procedurat e krijimit të politikave, strategjive, programeve dhe programeve horizontale duke i përfshirë edhe buxhetet fillon me analizën. Analiza është një hap i rëndësishëm e cila u siguron të gjitha palëve të përfshira të kenë një kuptim të mirë për nevojat e njerëzve në shtet, por edhe për të zhvilluar një kuptim të asaj se si krijohen buxhetet dhe si pasqyrohen në politikat dhe programet.

Nga këta arsye, analizat e situatave aktuale duhet që të jenë bazë e të dhënave gjinore të ndara statistikore, duke marrë në konsideratë dallimet e tilla si përkatësia etnike, mosha, arsimi, vendbanimi (rajoni), pengesa gjatë zhvillimit etj. Këto të dhëna mund të mbledhen duke i kombinuar planet zhvillimore kombëtare, politikat qeveritare të përfshira në një numër të dokumenteve strategjike, statistikat, hulumtimet, universitetet, organizatat e shoqërive civile, institutet etj.

Në grumbullimin e dhënave është e nevojshme që të merren parasysh pabarazitë rajonale që ekzistojnë në Republikën e Maqedonisë dhe statusi i burrave dhe grave në ato rajone.

Pyetjet të cilët duhet t'i parashtroni në **analizën e gjendjes** paraqitet në vijim:

1. Nëse aspektet gjinore janë pjesë nga analiza e gjendjes?
2. Nëse analiza e gjendjes jep pasqyrën e të dhënave statistikore për çështjet gjinore?
3. Cilat janë probemet specifike në sektor dhe në cilën mënyrë ndikojnë ato te burrat dhe gratë?
4. Ku dallohen pabarazitë gjinore ne sektor?
5. Cila është arsyeja për pabarazitë e këtilla?
6. Cilat janë vështirësitë dhe problemet në sigurimin e barazisë së gjinive në sektorin i cili është subjekt i analizës?
7. Cilat janë implikimet nga pabarazimet gjinore në sektor?

Meqë qëllimi i këtij hapi është njohja e pabarazive, gjinia - statistika e ndarë është burim i rëndësishëm i informacioneve që reflekton, mirëpo pa deklaruar arsyet e gjendjes së këtyre. Prej këtu, hap jashtëzakonisht i rëndësishëm në krijimin e politikave dhe strategjive të institucionit është ajo se ata janë të bazuar në të dhënat sasiore të ngurta të ndara sipas gjinisë, gjithmonë duke përfshirë edhe analizën cilësore në interpretimin e gjendjeve të këtyre.

Prej këtu, çështjet gjinore duhet të jenë një pjesë integrale e çdo analize qeveritare apo resoriale.

2. Analizë e politikës /programi dhe ndikimi i tij ndaj çështjeve gjinore

Hapi i dytë i dedikohet analizës së politikave qeveritare, strategjive dhe programeve në sektor të caktuar, të cilët mund të ndikojnë pozitivisht, negativisht apo neutral ndaj pabarazive gjinore.

Pikërisht në këtë kontekst, parashtrahet pyetja se çfarë aktivitete ndërmerren në drejtim të trajtimit me pabarazitë ekzistuese dhe nëse strategjitë e propozuara përpiqen të përballohen me këto pabarazi, të identifikuar me analizën e gjendjes.

Pyetjet të cilat do t'ju ndihmojnë në identifikim e aspektit gjinor në **politikat, strategjitë dhe programet** në vijim:

- 1.Nëse nevojat dhe interesat e burrave dhe grave, duke i përfshirë edhe problemet me të cilat ballafaqohen, në përgjithësi janë marrë parasysh në krijimin e politikës, strategjisë apo programet e institucionit?
- 2.Nëse është bërë vlerësim i ndikimit të asaj se kush do ta ketë dobinë e fundit apo përfitimin nga politikat, strategjitë dhe programet dhe në cilën mënyrë?
- 3.Çfarë ndryshime tjera mundet të propozohen gjatë programeve rrjedhëse, që të përmirësohet pozita e kategorive dhe grupeve të caktuara/burra dhe gra?
- 4.Në cilën masë qëllimet e politikave dhe programeve në një sektor të caktuar korrespondojnë në definimin e problemeve të programeve, përkatësisht nëse në definimin e problemeve janë marrë parasysh dallimet gjinore?
- 5.Çfarë intervenime merren që të tejkalohen këto probleme?
- 6.Nëse ata të cilët i marrin këto intervenime i kuptojnë pabarazitë gjinore dhe janë sensibilizuar për këto çështje?
- 7.Po qe se në implementimin e politikave dhe programeve, është e involvuar teknologji e re nëse ajo do ta rrisë apo do ta lehtëson barrën mbi gratë?
- 8.A është i nevojshëm trajnimi plotësues?
- 9.Nëse janë të nevojshme masa afirmative të cilat do të sigurohen përfundim të barabarta edhe për gratë?

Gjatë këtij hapi e rëndësishme është që të merret parasysh konteksti më i gjerë, ndërsa jo vetëm ajo në sektorin e përcaktuar.

Në kontekst të buxhetit gjinor këtu vëmendja duhet që të përqendrohet kah pjesa “aktivitete” të definuara në planet strategjike dhe programet qeveritare për punë. Ato i paraqesin intervenimet të cilët më tej do të ndërmerren dhe buxhetohen. Për atë ata duhet të jenë shembull i analizës.

3. Analiza e alokimeve buxhetore

Në këtë hap bëhet vlerësimi, nëse resurset përkatëse dhe mjetet nga buxheti alokohen në implementimin gjinor të politikave të ndjeshme të cilat do ti adresojnë problemet e identifikuar në hapin 1 dhe hapin 2.

Çfarë është e nevojshme në këtë hap, është që të bëhet dallimi në mes të tre kategorive shpenzimeve nga një perspektivë gjinore: Pyetjet të cilat ju mund ti parashtroni në **analizimin e alokimeve buxhetore** janë në vijim:

1. Shpenzimet specifike të dedikuara për gratë apo burrat – këta shpenzime janë specifike në 1 të drejtuara ndaj grupit të caktuar në tërësi (burra, gra etj)
2. Shpenzimet e dedikuara për promovim të barazisë gjinore në shërbimet publike: përfaqësim i barabarta i burrave dhe grave në strukturat vendimmarrëse, trajnime, përsoshmëri profesionale etj.
3. Shpenzime gjenerale apo shpenzime – në të cilët janë përfshirë çështjet gjinore. Kjo kategori e shpenzimeve edhe pse mundet që të shihet neutrale në pamje, përsëri në bazë mundet që të ketë efekte të ndryshme në raport të burrave dhe grave.

Prandaj, në analizën e buxhetit duhet të merret parasysh llogaritja e lidhshmërisë së buxhetit për vitin e planifikuar me Planet vjetore për punë në Ministrinë dhe planet strategjike të institucioneve. Sepse, siç është bërë më sipër dallimi linjear dhe buxhetimi i programit, këto dokumente janë një lloj zëvendësimi i plotë d.m.th shfrytëzohen për nevojat e buxhetimit gjinor.

4. Ndjekja e shpenzimeve dhe sigurimi i shërbimeve

Hapi i katërt e ndjek mënyrën në të cilën politika zbatohet dhe nëse shpenzimet e alokuara janë të shpenzuara sipas të të planifikuarës ose ekzistojnë probleme të caktuara.

Çështja kryesore këtu është jo vetëm nëse mjetet janë të shpenzuara, por që kush e ka dobënë përfundimtare të mjeteve.

Pyetje në këtë hap të cilët e lehtësojnë procedurën e **ndjekjes së shpenzimeve në vijim:**

1. Çfarë fitohet si rezultat nga implementimi i hapave të mëparshëm?
2. Nëse mjetet janë shpenzuar ashtu siç janë planifikuar?
3. Çfarë është dërguar dhe për kë?
4. Kush dhe në çfarë mënyre ka dobi nga kjo që është bërë?

Monitorimi është një mjet i rëndësishëm i cili siguron që aktivitetet të implementohen në kohë dhe mjetet të shpenzohen në përputhje me të planifikuarën. Në të njëjtën kohë, siguron transparencën dhe llogaridhënien në procesin e shpenzimit të mjeteve dhe realizimin e aktiviteteve.

Mjetet dhe instrumentet që përdoren në procesin e gjetjes (monitorimit) dhe vlerësimit të politikave dhe programeve është po aq e rëndësishme që të projektohen në një mënyrë që do të tregojnë qartë dallimet që ekzistojnë në kategorinë e shfrytëzuesve, burra dhe gra.

Sigurisht se gjatë këtij hapi më lehtë e perceptueshme është nevoja nga programi buxhetor i plotë, sepse me buxhetimin linear nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë në mes të planit të realizimit dhe kategorisë së shpenzimeve etj, nuk është gjithmonë e qartë nëse realizimi i mjeteve është shpenzimi i planifikuar.

5. Analizë e rezultateve

Analiza e rezultateve në analizën e buxhetimit gjinor përfshin nëse buxheti dhe strategjitë e duhura dhe programet e kanë përmirësuar situatën fillestare përshkruar në hapin 1, dhe i kanë promovuar parimet e barazisë. Në thelb, kjo i referohet vlerësimit se nëse politika, strategjia apo programi kanë kontribuar për disa ndryshime në lidhje me gjendjen fillestare.

Pyetjet që mund të ju ndihmojë për të kuptuar **efektet dhe ndikimet e intervenimit** në vijim:

1. Cili është ndikimi i programeve të implementuara dhe se a siguron qasje më të mirë të burrave dhe grave deri te shërbimet ekonomike dhe sociale?
2. Cilat janë efektet e aksioneve të ndërmarra në raport me reduktimin e varfërisë, veçanërisht për gratë dhe për grupet tjera të marginalizuara?

ANEKS 1 QAEKULLIM BUXHETOR

Formular A1

TË DHËNA PËR SHFRYTËZUESIT E BUXHETIT

Shfrytëzues i Buxhetit: _____

Ndarje: _____

RKB: _____

Adresa: _____

Personi për kontakt: _____

Bumri i telefonit: _____

Email: _____ Website _____

Përshkrimi dhe karakteristikat kryesore të shfrytëzuesit të buxhetit (jo më shumë se 8 rreshta)*

Rezultate të arritura në vitin 2011

-
-
-

Prioritete dhe qëëime në vitin 2012

-
-
-

Prioritete strategjike të përcaktuara në Planin strategjik (Ju lutemi bashkangjitni një kopje të Planit strategjik)

* Shembull: Si programi i zgjedhur për analizën gjinore kontribuon për mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat (të përshkruani në detaje ndikimin dhe efektet e programit për statusin e burrave dhe grave që jetojnë në zona të ndryshme)

**INFORMACIONE TË DETAJUARA MBI PROGRAMET BUXHETORE TE
SHFRYTËSUESIT E BUXHETIT**

Emri i programit buxhetor: _____

Numri i programit buxhetor: _____

Përshkrim i shkurtër i programit buxhetor:

**Indikatorë të propozuar në realizimin apo masat për vlerësimin e rezultateve
në vitin 2012:**

Treguesi i prodhimit*:

Definimi i treguesit:

Shpjegim/Rëndësia:

Përlllogaritja:

Treguesi i prodhimit sipas viteve të caktuara:

2011 2012 2013 2014

* Qarkorja Buxhetore nga viti 2012 kërkon që të jetë tregues gjinor senzitiv. Shembuj për treguesit e gjinisë sensitive tregohen në faqen 14 nga doracaku për përgatitjen e qarkores buxhetore.

ANEKS 2

BAZA LIGJORE PËR BUXHETIMIN GJINOR

Ligj për mundësitë e barabarta të grave dhe burrave

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më 13 janar të vitit 2012 ka miratuar Ligjin e ri për mundësi të barabarta të grave dhe burrave⁶. Me miratimin e këtij ligji promovohet çështja e krijimit të mundësive të barabarta dhe trajtimi i barabartë i grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Në nenin 4 të Ligjit, në përkufizimet e shprehjeve të veçanta të cilët shfrytëzohen në tekstin e mëtejshëm të Ligjit, për herë të parë në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë u definua termi *Përfshirje e perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore*, si në integrimin e perspektivës gjinore në çdo fazë të ndërtimit të procesit, sjelljen, ndjekjen dhe vlerësimin e politikave – më pastaj, duke pasur parasysh promovimin dhe avancimin e barazisë ndërmjet grave dhe burrave.

Me sjelljen e këtij përkufizimi të Ligjit obligohen që të gjitha subjektet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji të integrojnë perspektivën gjinore dhe ta promovojnë barazinë ndërmjet grave dhe burrave.

Ligji parashikon dy lloje të masave themelore dhe të veçanta për krijimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, dhe në mënyrë shumë të qartë dhe të thjeshtë e përshkruan mënyrën e miratimit dhe monitorimin e këtyre masave.

Në nenin 5 të Ligjit, pranë përcaktimit të llojeve të masave themelore në paragrafin 3 thuhet se "Masat themelore janë dhe masat që prezantojnë përfshirjen sistematike të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në vendim marrje, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe buxheteve në fusha të caktuara shoqërore, duke përfshirë kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi të sektorit publik dhe privat". Me këtë dispozitë të Ligjit, ligjvënësi imponon një detyrë për të gjithë subjektet përgjegjëse në nivel lokal dhe kombëtar për përfshirjen e mundësive të barabarta për gratë

⁶ Gazeta zyrtare e RM-së nr.6/2012

dhe burrat në vendim marrje, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe buxheteve.

Në nenin 7, paragrafi 1, ligji tregon natyrën e përkohshme të masave të posaçme i cili qëllim është për të kapërcyer pozitën ekzistuese të pafavorshme sociale të grave dhe burrave, e cila është rezultat i diskriminimit sistematik ose pabarazisë strukturore gjinore e dalë nga rrethanat historike dhe socio-kulturore. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, masat e veçanta synojnë në heqjen e pengesave ose dhënien e kontributit të veçantë dhe nxitjet për arritjen e pozitave të barabarta të grave dhe burrave, trajtim i barabartë, pjesëmarrje e balancuar apo status i barabartë shoqëror, zhvillim individual të potencialit të tyre individual përmes të cilëve ata kontribuojnë në zhvillimin social dhe shfrytëzim të barabartë të dobive nga ky zhvillim.

Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, masa të veçanta që synojnë në heqjen e pengesave ose duke dhënien e kontributit të veçantë dhe nxitje për shkak të realizimit të pozitave të barabarta dalëse të grave dhe burrave, trajtim i barabartë, pjesëmarrje e balancuar apo status i barabartë shoqëror, zhvillim individual i potencialit të tyre përmes të cilëve ata kontribuojnë në zhvillimin social dhe shfrytëzimin e barabartë të përfitimeve nga ky zhvillim.

Legjislatori parashikon tre lloje të posaçme të masave: pozitive, inkurajuese dhe masa programore dhe këto i përcakton në paragrafin 3 të nenit 7 të ligjit.

Gjatë përcaktimit të obligimeve dhe përgjegjësi të subjekteve përgjegjëse për miratimin dhe zbatimin e masave për krijimin e mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, **në nenin 10**, paragrafi 6 i Ligjit parashihet që Qeveria të formon grup ndër-sektorial konsultativ dhe këshillues për mundësitë e barabarta të grave dhe burrave, e përbërë nga zyrtarë/zyrtarë shtetërorë udhëheqës, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, shoqatat e punëdhënësve, ekspertë, përfaqësues të pushtetit lokal, sindikatat dhe subjektet e tjera. Grupi ndër-sektorial është i detyruar për të promovuar konceptin e aspekteve gjinore në politikat e përgjithshme të të gjitha institucioneve publike, të ndjek integrimin e konceptit në politikat sektoriale në bashkëpunim me partnerët social dhe në

institucionet e zonave individuale; të ndjek progresin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me Bashkimin Evropian dhe standardet evropiane në fushën e çështjeve gjinore, të merr pjesë në procesin e përgatitjes dhe të ofron udhëzime në përgatitjen e Strategjisë për barazi gjinore; dhe të ndjek raportet periodike nga institucionet. Puna e saj do të koordinohet nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Organet e administratës shtetërore, në përputhje me **nenin 11**, paragrafi 3, ***janë të obliguar që në kuadër të planeve të tyre strategjike dhe buxhetore të përfshijnë parimin e mundësive të barabartë për gratë dhe burrat***; të ndjekin efektet dhe ndikimin e programeve të tyre mbi gratë dhe burrat dhe të njoftojnë mbi ndërmarrjen e aktiviteteve të tyre në kuadër të raporteve vjetore të paraqitura në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe i publikojnë ato në ueb faqet e tyre. Këtë obligim organet në administratën shtetërore e kryejnë nëpërmjet koordinаторit dhe zëvendës koordinatorit për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat të cilët i koordinojnë funksionet e një autoriteti publik për krijimin e mundësive të barabarta.

Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave parasheh një detyrim për Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, të kujdeset për futjen e parimit të mundësive të barabarta, në rrjedhë të riorganizimit, përmirësimit, zhvillimit dhe vlerësimit të proceseve politike në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat kombëtare dhe lokale.

Në Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në **nenin 14**, paragrafi 2, parashikoi angazhim për njësitë e qeverisjes vendore, sipas të cilës, brenda planeve të tyre strategjike dhe buxhetore të përfshihet parimi i mundësive të barabarta për gratë dhe burrat; të ndjekin efektet dhe ndikimin e programeve të tyre mbi gratë dhe burrat dhe të raportojnë brenda raporteve të tyre vjetore dhe të marrin pjesë në përgatitjen e Strategjisë për barazi gjinore në pjesën që lidhet me njësitë e qeverisjes vendore. Përfshirja e parimit të mundësive të barabarta në punën e qeverisë lokale dhe administratës komunale kryhet nga Komisioni dhe koordinatori për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, në të cilën pushteti lokal është i detyruar të krijojë ose të caktojë një person për koordinator.

FJALOR

Planifikimi strategjik apo planifikimi afatmesëm është proces në të cilin përcaktohen prioritetet dhe objektivat të cilët konsiderohen si më të rëndësishme, përcaktohen programet, projektet dhe aktivitetet nëpërmjet të cilit do të realizohen përparësitë e përcaktuara dhe përcaktohen burimet e nevojshme për realizimin e prioriteteve përmes procesit buxhetor.

Buxheti është një akt i shtetit në të cilin janë të paraparë të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe të dalat e shtetit për një vit.

Buxheti i RM-së paraqet akt i RM-së me të cilin parashikohet që të gjitha të hyrat dhe flukse tjera si dhe të dalat dhe deflukse tjera në shtet për një vit. Përpunohet për një vit. E pranon Parlamenti i RM-së sipas procedurës e përshkruar në mënyrë specifike. Buxheti i shtetit është një mjet i rëndësishëm me të cilin disponon qeveria në zbatimin e politikës shumëvjeçare makroekonomike, e cila ka për qëllim që të siguron stabilitetin e financave publike dhe të promovojë zhvillimin ekonomik dhe social. Detyra kryesore në administrimin e buxhetit dhe për qëllimet të cilët ka qenë i pranuar, në kohë të duhur është përshtatja e tij në kohë dhe për ndryshimet e rrethanave fiskale (kushte), dhe për realizimin e objektivave sociale dhe ekonomike të përcaktuara në buxhet

Kërkesat buxhetore japin një përmbledhje të detajuar të mënyrave në të cilat shfrytëzuesit e buxhetit do të ndajnë resurset sipas programeve dhe projekteve të përmbajtura në Planin strategjik.

Programet buxhetore përfaqësojnë veprimtari kryesore apo grup i aktiviteteve të cilët zbatohen në përputhje me detyrimet e përcaktuara me ligj dhe me legjislacion tjetër.

Programet vertikale janë planifikuar dhe zbatuar në një resor/ministri.

Programet horizontale janë mjaft komplekse dhe parashikojnë planifikim dhe zbatimin e disa nën-programeve dhe / ose projekte nga ana e më shumë resoreve / ministrive dhe organeve të administratës shtetërore për arritjet e qëllimit të përbashkët apo programës.

Nën-programi është aktivitet apo projekt e cila është pjesë përbërëse e programit.

Buxheti programor është prezantimi i informatave buxhetore në

mënyrë në të cilin qartë lidhen burimet buxhetore me rezultatet e fundit të politikave që ata duan të arrihen.

Alokimi i burimeve është përlogaritja e mjeteve materiale në ndonjë vend tjetër.

Analiza e buxhetit është vlerësimi i buxhetit nga ana e grupeve të ndryshme të interesit

Deficiti buxhetor është dallim negativ ndërmjet të planifikuarave, përkatësisht të ardhurat e paguara dhe mjetet e miratuara, përkatësisht të dalat dhe të njëjtit financohen me mjete të siguruar nga të hyrat tjera.

Shfrytëzues buxhetor janë shfrytëzues të linjës së parë nga legjislativi, ekzekutivit dhe gjyqësorit, fondet, shfrytëzuesit e buxhetit komunale dhe shfrytëzuesit e përcaktuar me ligj ngarkuar me kryerjen e autorizimeve publike

Tepricë buxhetore – Situatë kur të ardhurat e qeverisë i tejkalojnë shpenzimet

Menaxhim i mirë (good governance). Proces i cili i përmirëson aftësitë e shpërndarjes të resurseve dhe shërbimeve të popullsisë në mënyrë të drejtë, të barabartë, efikase dhe të përgjegjshme. Karakteristikat përfundimtare janë transparencë, përgjegjshmëri dhe bashkëpunim.

Politika ekonomike – Pranon përcaktimin e drejtimeve dhe qëllimeve të zhvillimit dhe sistemit ekonomik na masa të cilët e sigurojnë zhvillimin. Politika ekonomike përbëhet nga tre elemente: qëllimet, mjetet dhe bartësit të cilët e përcaktojnë fuqitë qeveritare në shoqëri; mjetet janë të ndryshme fiskale, investime kreditore etj; mbajtësit janë organet shtetërore dhe shoqërore

Ekzekutimi i Buxhetit - Zbaton politikën e miratuar të buxhetit për realizimin e të ardhurave publike, që do të përdoren për të financuar nevojat e caktuara sociale.

Ekzekutimi i buxhetit – Zbatimi i politikës së miratuar të buxhetit për realizimin e të ardhurave publike të cilët do të shfrytëzojnë nevojat e caktuara financiare sociale.

Shpenzimet janë pagesat (daljet) nga buxheti për qëllime të miratuara përveç shlyerjes së kredive kryesore.

Të hyrat janë tatime dhe pagesa tjera të detyrueshme të përcaktuara me ligj, të ardhurat të cilat rrjedhin në pronësi të

mjeteve (interes, dividendë, qira, etj), kompensime të dhëna për shërbime të caktuara, dhurata, donacione, subvencione dhe transferimeve.

Fiskal (viti buxhetor) - Periudha prej dymbëdhjetë muajsh për të cilat shteti planifikon të hyrat dhe të dalat, zakonisht i përputhet vitit kalendarik.

Politika fiskale - Politika e taksave, shpenzimeve dhe huamarrjes nga ana e qeverisë e cila shfrytëzohet që të ndikojë në kushtet makroekonomike. Toleranca politike fiskale ndërmerret me qëllim që të stimulohet rritja afat-shkurtër ekonomike me zmadhimin e shpenzimeve qeveritare apo reduktimin e ty hyrave. Politika restriktive fiskale, i kufizon kërkesat afatshkurtra me reduktimin e shpenzimit apo rritjen e taksave, dhe më së shumti shfrytëzohet për inflacion. Qeveria zbaton politikën fiskale përmes buxhetit.

Rebalanci i buxheti – Ndryshim i marrëdhënieve buxhetore, përkatësisht reduktimi i tyre apo rritja në raport me buxhetin e planifikuar fillimisht. Kryhet gjatë gjithë vitit fiskal.

Gjinia-I identifikon marrëdhëniet sociale midis burrave dhe grave. Gjinia i referohet marrëdhënieve ndërmjet burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, dhe se si kjo marrëdhënie është e ndërtuar shoqërisht. Gjinia është identitet i fituar i cili është shkencor, ndryshohet me kalimin e kohës dhe ndryshimin mes kulturave.

Barazia gjinore - Barazia gjinore nënkupton drejtësinë gjatë vendosjes me burrat dhe gratë në përputhje me nevojat e tyre personale, drejtësi veçanërisht në lidhje me të drejtat, përfitimet, detyrimet dhe mundësitë. Barazia gjinore është cekur me promovimin e barazisë personale, sociale, kulturore, politike dhe ekonomike për të gjithë.

Barazia gjinore - Barazia gjinore do të thotë se sjelljet e ndryshme, aspiratat, nevojat e grave dhe burrave janë respektuar, konsideruar, vlerësuar, dhe mbështetur në mënyrë të barabartë. Kjo do të thotë se të drejtat e tyre, përgjegjësitë dhe mundësitë nuk do të varet nga fakti nëse ata janë të lindur si burrë apo si grua. Ajo është e bazuar në parimet e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë sociale.

Analiza gjinore – Metodologjia për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit në lidhje me gjininë. Ajo siguron të dhëna të ndara sipas gjinisë, si dhe kuptimin e konstruktit social të roleve gjinore, si

është ndarë dhe vlerësuar puna. Analiza gjinore është një mjet i informacioneve me qëllim që të sigurohet që përfitimet dhe burimet në mënyrë efektive dhe të barabartë të drejtuar kah gratë dhe burrat dhe me sukses të parashikohet dhe të shmangen që ndikimet dhe intervenimet mund ti kenë mbi gratë ose marrëdhëniet midis burrave dhe grave. Analiza gjinore bëhet përmes një shumëllojshmërie të mjeteve dhe kornizave.

Të dhëna të ndara gjinore - Për të bërë analizë gjinore, të gjitha të dhënat duhet të jenë të ndara sipas gjinisë, në mënyrë që të mundësohet matja e ndikimeve të ndryshme për gratë dhe burrat. Përcaktimi dhe përgatitja e statistikës gjinore është një proces kompleks që e tejkalon ndarjen e treguesve të kategorive burra dhe gra. Të dhënat e ndara gjinore janë përqendruar ndaj çështjeve të cilat kanë rëndësi të veçantë për gratë dhe burrat dhe rolet e tyre të ndryshme dhe pozita në shoqëri.

Planifikimi gjinor - I referohet procesit të planifikimit të programeve zhvillimore dhe projekteve të ndjeshme gjinore dhe që i marrin parasysh ndikimin e roleve gjinore dhe role të nevojave të grave dhe burrave në komunitetin e synuar ose të sektorit. Ajo përfshin zgjedhjen e metodave të përshtatshme për zgjidhjen e nevojave jo vetëm të grave dhe burrave, nevojat praktike, por edhe identifikimin e pikave të hyrjes që shkaktojnë pabarazi midis grave dhe burrave dhe për rritjen e përgjegjshmërisë gjinore në dialog politik.

Vetëdija gjinore - Për të kuptuar se ka dallime të përcaktuara shoqërore midis grave dhe burrave në bazë të sjelljes së mësuar, e cila ndikon në qasjen dhe kontrollin e burimeve. Ky kuptim duhet të zbatohet nëpërmjet analizës gjinore në projektet, programet dhe politikat.

Verbëri gjinore – Dështim është që të pranohet se gjinia është një faktor i rëndësishëm i rezultateve sociale që prekin projektet dhe politikat. Verbëria gjinore qasje e cila supozon se gjinia nuk është faktor që ndikon në planifikimin e projekteve.

Ndjeshmëri gjinore - Aftësia për të njohur dhe të nxirren në pah dallimet ekzistuese gjinore, çështjet dhe pabarazitë dhe përfshirja e tyre në përgatitjen e projekteve dhe politikave.

Buxhetim gjinor i përgjegjshëm – Buxheti gjinor i përgjegjshëm reflekton vullnetin politik dhe hapat e marra në arritjen e barazisë gjinore, duke zbatuar praktikën e përfshirjes së perspektivës gjinore

në proceset e buxhetimit. Kjo nuk nënkupton buxhete të ndara për gratë, por do të thotë vlerësim i buxheteve në drejtim të barazisë gjinore dhe përfshirjen e perspektivave gjinore në të gjitha nivelet në procesin e buxhetimit.

Iniciativa buxhetore gjinore – Iniciativa për proceset e buxheteve të sensibilizimit gjinor. Qëllimi i tyre është që të sigurojë një mekanizëm me të cilin qeveritë, në bashkëpunim me parlamentet, grupet qytetare, donatorëve dhe agjenci tjera për zhvillim, do të mund të integrojnë perspektivën gjinore në planifikim, krijim dhe zbatimin e buxhetit.

BIBLIOGRAFIA

- *Parlament, buxhet dhe gjini*, përgatitën, Venher, J., dhe Bianima, V IPU, UNDP, VBI dhe UNIFEM (botim maqedonas), Shkup, 2009
- *Buxhetim gjinor: udhëheqëse*, Tatjana Gjuriç Kuzmanoviç, Studime dhe hulumtime femërore: Publikim Futura , Novi Sad, 2007.
- M. Ivanova., *Udhëheqëse në terminologjinë feministe dhe gjinore*, Akcion Zdruzhenska, Shkup, 2007.
- How to do a gender-sensitive budget analysis: Contemporary research and practice, Debbie Budlender, Rhonda Sharp & the Commonwealth Secretariat, 1998
- Ligji për mundësi të barabarta, Gazeta Zyrtare, nr 6/2012, Shkup
- Plani nacional për barazinë gjinore 2007-2017
- Gender and Participatory Budgeting – CIPFA&DFID – Technical Brief on International Development best practice
- Gender Budgeting in the EU – Elizabeth Villagomez, Almenara
- Gender Budgets Make Cents – Understanding gender responsive budgets, Gender Affairs Department – Commonwealth Secretariat
- Gender Budgeting Handbook for Government of India Ministries&Departments – Case Studies of Gender Budgeting
- Gender Budgets Make More Cents Country Studies and Good Practice, Debbie Budlender and Guy Hewitt, <http://www.gender-budgets.org/content/view/154/153/>
- Budgeting for equity: Gender budget initiatives within a framework of performance oriented budgeting, Rhonda Sharp, http://www.genderbudgets.org/component/option,com_docman/task,doc_view/gid,70/
- “Budgeting for Women’s Rights, Monitoring Government

for Policy Makers, Gender Equality and Human Rights Advocates”, UNIFEM 2008, based on Diane Elson’s publication “Budgeting for Women’s Rights: Monitoring Government Budgets for Compliance with CEDAW’ <http://www.gender-budgets.org/content/view/650/153/>

- Engendering Budgets A Practitioners Guide to Understanding and Implementing Gender-Responsive Budgets, Debbie Budlender and Guy Hewitt, <http://www.gender-budgets.org/content/view/165/153/>
- Analiza buxhetore – gjinore e mbrojtjes sociale dhe politikat aktive të punësimit në Republikën e Maqedonisë, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale të Republikës së Maqedonisë, viti 2010,
- <http://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Rodova%20Analiza%20Makedonski%2023%2002%202010.pdf>
- Ministria e financave, www.finance.gov.mk

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

305:[336.12:354(497.7)(035)

DORACAK për buxhetim përgjës gjinor për administratën e
Rëpublikës së Maqedonisë. - Shkup : Ministria e punës dhe politikës
sociale, 2013. - 37 стр. ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 37. - Содржи и: Anekset 1-3

ISBN 978-608-4595-28-1

а) Родово одговорно буџетирање - Македонија - Прирачници
COBISS.MK-ID 93780490



REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE